



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

### NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të tërthortë të shoqërisë GEDI Gruppo Editoriale S.p.A nga shoqëria EXOR N.V

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi në lidhje me transaksionin e përfimitit e kontrollit të shoqërisë GEDI Gruppo Editoriale S.p.A nga shoqëria EXOR N.V .

Palët pjesëmarrëse:

Pala Blerëse. EXOR N.V është një shoqëri me seli ligjore në Amsterdam, Hollandë, me aksione të kuotuar në Mercato Telematico Azionario, organizuar dhe administruar nga Borsa Italiana S.p.A.

EXOR N.V. i përket shoqërive të Grupit EXOR ("Grupi EXOR"). Aktiviteti i Grupit konsiston në investime afat-gjata me një fokus në shoqëritë aktive globale në sektorë të ndryshëm, kryesisht në Europë dhe në SHBA. Grupi EXOR ka mbi 300,000 punonjës në tërë botën.

Pala shitëse. CIR- Compagnie Industriali Riunite S.p.A me seli ligjore në Milano, regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve të Milanos dhe me aksione të kuotuar në Mercato Telematico Azionario, organizuar dhe administruar nga Borsa Italiana S.p.A.

Shoqëria Target. GEDI Gruppo Editoriale S.p.A. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, me seli të regjistruar në Romë, Itali me nr. 00488680588, me aksione të kuotuar në Mercato telematico Azionario, organizuar dhe administruar nga Borsa Italiana S.p.A., segmenti STAR( segmenti për titujt me kërkesë të lartë në fushën e transparencës së informacionit, të likuiditetit dhe qeverisjes së korporatave).

GEDI, drejtpërdrejt dhe nëpërmjet filialeve të saj, është aktive në sektorin e medias kryesisht në Itali, në sektorët e botimit, komunikimit dixhital të radios dhe televizionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**